

VENDIM
Nr.280, datë 29.10.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “LEZHA”

SUBJEKTIT: Z. FRED STAKAJ

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Fred Stakaj, licencë, duke autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televisionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Lezhës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Albert Minga